

## VENDIM

Nr. 907, datë 17.12.2014

### **PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR SIGURIMIN E FINANCIMIT TË NEVOJSHËM TË KONTRATËS SË KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTIT TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT TË ELBASANIT DHE PRODHIMIN E ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27 e 41, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë, sipas aneksit B, të kësaj kontrate, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



KRYEMINISTRI

Edi Rama